

## MENDIM PARALEL

Une, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit, z. Alket Mersini, dakordësohem me vendimin e trupit gjykues, por parashtroj arsyetimin paralel lidhur me konkluzionet e trupit gjykues, për sa vijon:

**1. Lidhur me apartament banimi me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, në Elbasan,** analizuar si burim krijimi për apartamentin e banimit me sip 110 m<sup>2</sup>, ndodhur në “\*\*\*”, Tiranë.

Kjo pasuri rezulton e deklaruar prej subjektit në DPV/2004, duke specifikuar në DPV/2004 si burim krijimi, shuma dhënë nga vëllai i subjektit prej 10,000 USD, dhe shuma dhuruar nga familjarët e bashkëshortes prej 10,000 USD.

Referuar dokumentacionit rezulton se deklarata e prindërve të bashkëshortes, ku ata konfirmojnë se i kanë dhuruar vajzës së tyre znj. M.M., shumën prej 10,000 USD për blerjen e shtëpisë së saj është depozituar në ILDKPKI, që në DPV-në e vitit 2004.

Referuar dokumentacionit, deklarata e vëllait, z. E.M., në të cilën konfirmon dhënien e shumës prej 10,000 USD, subjektit të rivlerësimit është depozituar në ILDKPKI, në DPV-në e vitit 2004.

Pas analizës financiare të kryer lidhur me *burimet financiare të ligjshme për krijimin e shumave*, trupi gjykues ka arritur në konkluzionet se:

*“ ... trupi gjykues krijoi bindjen se familjarët e bashkëshortes së subjektit kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumës prej 10,000 USD marrë nga subjekti dhe personi i lidhur.*

*... z. E. Mersini, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës 10,000 USD, të deklaruar si e dhënë në favor subjektit të rivlerësimit (për heqje dorë nga bashkëpronësia e apartamentit në lagjen “\*\*\*”, Elbasan) ”.*

Duke mbajtur në konsideratë se nga provat e administruara në hetim nuk rezultoi asnjë fakt apo rrethanë që të vërë në dyshim vërtetësinë e deklarimeve të bëra që në vitin 2004 nga të afërmit mbi dhënien e këtyre shumave subjektit dhe bashkëshortes, e vetmja rrethanë, pasaktësia e datave, e cila u shpjegua nga subjekti referuar situatës faktike, të deklarimit të kësaj pasurie, nuk mund të vërë në dyshim faktin se këto vlera kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë.

Në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, dhe vlerësimin e çështjes në tërësi, këto dy vlera monetare, duheshin marrë në konsideratë duke u reflektuar në analizën financiare të kryer për periudhën 1.3.1996 – 31.12.2003.

### **2. Lidhur me autoveturë tip “Mercedes-Benz”**

Referuar situatës faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit, provuar gjatë hetimit në Komision, subjekti kishte detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie, në zbatim të përcaktimeve të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit përcaktohej se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.*

Për sa më sipër, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting* duke mos e deklaruar përdorimin e këtij mjeti prej tij.

Përtej këtij konkluzioni, rezultoi se subjekti e deklaroi këtë përdorim gjatë hetimit administrativ, për rrjedhojë nuk e ka fshehur atë, dhe për sa nuk u ngritën dyshime apo nuk u provua pamundësia financiare për pronarin e automjetit, lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, vlerësoj se rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ janë të pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin se ky automjet është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **ANËTARE**

**Xhensila PINE**